



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**Data:** 11 Shkurt 2021

**Nr:** 48

**VENDIM**

**PËR NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË VULËS SË KZAZ-SË NR. 38, QARKU  
TIRANË DHE ZËVENDËSIMIN ME VULË REZERVË**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, gërma “n”, dhe 2, nenin 99, paragrafët 1, shkronja “b” dhe 2, nenin 103, paragrafët 1 dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**VËREN**

KZAZ –ja nr. 38, Qarku Tiranë, me shkresën nr. 909 prot, datë 04.02.2021, informon Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, për humbjen e vulës, rrethanat, si dhe kërkon pajisjen me vulë rezervë.

Bazuar në informacionin e KZAZ-së nr. 38, nënshkruar nga gjashtë anëtarët dhe sekretari, në datën 03.02.2021 nga ana e sekretarit të KZAZ nr. 38, u raportua se ka humbur vula. Duke qenë se në ambjentet e KZAZ-së nuk ka kasafortë, sekretari, për arsye sigurie e ka mbajtur me vete vulën. Sapo ka konstatuar humbjen e saj, ka vënë në dijeni anëtarët e KZAZ-së nr. 38.

Në këto kushte, KZAZ nr. 38, kërkon nxjerrjen jashtë përdorimit të vulës së humbur dhe pajisjen me vulë rezervë.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, gërma “n”, dhe 2, nenin 99, paragrafët 1, shkronja “b” dhe 2, nenin 103, paragrafët 1 dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,



## VENDOSA:

1. Të nxjerrë jashtë përdorimit vulën e KZAZ-së nr. 38, Qarku Tiranë, e prodhuar sipas modelit të Vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 4, datë 07.01.2021.
2. Të zëvendësojë vulën e KZAZ-së nr. 38, Qarku Tiranë me vulë rezervë sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**



Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021:

Formati i Vulës: KZAZ



**Legjenda:**

1. Diametri = 38 mm
2. Stema e Republikës së Shqipërisë
3. tekst: Republika e Shqipërisë
4. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
5. Numri i Identifikimit: KZAZ- R- 38.
6. tekst: Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021